



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-019
Prishtinë, më 21 shkurt 2018, në orën 16:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 21 SHKURT 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Aida Dërguti, Kujtim Shala, Xhavit Haliti dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Glauk Konjufca, Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerand Stavileci, Valmir Klaiqi dhe Avni Bytyqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Ambasada Amerikane: Adem Gashi dhe Emma Lomax,

Nga OSBE-ja: Zoja Nushi,

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë rend të ditës:

1. Shqyrtimi i kërkesës së kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, për seancë të jashtëzakonshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Qeveria e Republikës së Kosovës më 20 shkurt 2018 e ka proceduar në Kuvend Projektligjin nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, si dhe Komisioni Funkcional për Punë të Jashtme më 21 shkurt 2018 e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin.

Më pas, kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme nga Kuvendi më 22 shkurt 2018, në orën 11:00, me këtë rend dite: *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.*

Në vazhdim, kryetari kërkoi mirëkuptimin nga grupet parlamentare që shqyrtimi i këtij projektligji të bëhet me shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit, si dhe i njoftoi për procedurat lidhur me shmangien nga afatet e parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Më pas, kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti, e shtroi çështjen lidhur me pikën 1.2 të nenit 3 të Projektligjit nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, të dërguar në Kuvend nga Qeveria e Republikës së Kosovës, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Në lidhje me çështjen e shtruar nga z. Hoti, si dhe për kërkesën e kryeministrit për seancë të jashtëzakonshme diskutuan: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Kujtim Shala dhe Aida Dërguti, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së dhe Bilall Sherifi, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit, sipas kërkesës së kryeministrit, z. Ramush Haradinaj, të mbahet më 22 shkurt 2018, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

* * *

2. Pikat shtesë:

Në vazhdim, Kryesia i shqyrtoi edhe pikat shtesë të rendit të ditës, si në vijim:

1. Kërkesa për lejimin e pjesëmarrjes në Konferencën Ndërparlamentare, e cila do të mbahet në Shkup (Maqedoni), prej 25-27 shkurt 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Safete Hadërgjonaj, Dardan Molliqaj, Driton Selmanaj dhe Andin Hoti u lejohej udhëtimi zyrtar në Shkup (Maqedoni), prej 25-27 shkurt 2018.

2. Shpenzimet e akomodimit, udhëtimit, transporti dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa nga Parlamenti Evropian do të rimbursohen shpenzimet e udhëtimit, për 2 (dy) net të akomodimit dhe mëditjet.

2. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Podgoricë (Mali i Zi), prej 23-25 shkurt 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ismajl Kurteshi, i lejohej udhëtimi zyrtar në Podgoricë (Mali i Zi), prej 23-25 shkurt 2018.

2. Shpenzimet lidhur me realizimin e këtij udhëtimit zyrtar për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas kërkesës nr. 06/720/Do-445, datë 14.02.2018 të bashkangjitur.

3. Kërkesa e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për lejimin e vizitës zyrtare në Podgoricë (Mali i Zi), prej 25-28 shkurt 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Anëtarëve të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivković, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili, Arban Abrashi, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli u lejohej udhëtimi zyrtar në Podgoricë (Mali i Zi), prej 25-28 shkurt 2018.

2. Shpenzimet e akomodimit, udhëtimit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Kërkesa e deputetit Danush Ademi për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani, prej 23-26 shkurt 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Danush Ademi, i lejohet udhëtimi zyrtar në Gjermani prej 23-26 shkurt 2018.

2. Shpenzimet e akomodimit, udhëtimit dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri, prej 23-26 shkurt 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Anëtarëve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Saranda Bogujevci, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj-Halimaj u lejohet udhëtimi zyrtar në Shqipëri prej 23-26 shkurt 2018.

2. Shpenzimet e transportit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa nga organizatori mbulohen shpenzimet e qëndrimit dhe akomodimit.

6. Kërkesa e deputetes Sala Berisha-Shala për lejimin e udhëtimit zyrtar në Toronto (Kanada), prej 3-9 mars 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Sala Berisha-Shala, i lejohet udhëtimi zyrtar në Toronto (Kanada), prej 3-9 mars 2018.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, qëndrimit, të pjesëmarrjes në konferencë dhe mëditjet për të lartshënuarën në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Shënim: Kryetari konstatoi se të gjitha vendimet e lejuara për udhëtime jashtë vendit nëse Kuvendi mbanë Seancë plenare anulohen.

7. Kërkesa e zyrtarit të Administratës së Kuvendit, Asllan Canolli, për ndihmë financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Zyrtari i Administratës së Kuvendit të Kosovës, z. Asllan Canolli, mbështetet financiarisht në shumën prej 2,000 (dy mijë) eurosh.
2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere dhe transferohen në xhironlogarinë bankare të zyrtarit Asllan Canolli.

8. Kërkesa e zyrtarit të Administratës së Kuvendit, Faton Parduzi, për ndihmë financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Zyrtari i Administratës së Kuvendit të Kosovës, z. Faton Parduzi, mbështetet financiarisht në shumën prej 1 500 (një mijë e pesëqind) eurosh.
2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere dhe transferohen në xhironlogarinë bankare të zyrtarit Faton Parduzi.

9. Kërkesa e OJQ-së Fondacioni “Pashtriku-Shigjeta” për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. OJQ-ja Fondacioni “Pashtriku-Shigjeta” mbështetet financiarisht në shumën prej 4 950 (katërmijë e nëntëqind e pesëdhjetë) eurosh.
2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere dhe transferohen në xhironlogarinë bankare të OJQ-së Fondacioni “Pashtriku-Shigjeta”, me numër 1501110003491393, në Raiffeisen Bank.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 17:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri Veseli

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale